



SYLLABUS I LËNDËS METODOLOGJIA E HULUMTIMEVE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Metodologjia e hulumtimeve
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	
Vlera në ECTS kredi:	8
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	
	Lënda Metodologjia e hulumtimeve përqendrohet në shpjegimin e rolit të kërkimit akademik në fushën e biznesit, ekonomisë dhe financës. Përkujdesje e veçantë do të bëhet që studentët të përvetësojnë mjeshtritë kryesore të studimit akademik, të identifikojnë burimet kryesore të diturisë për kërkimit në biznes dhe ekonomi, të njohin mirë procesin kërkimor në biznes dhe çështjet etike, të njihen me dizajnin e punës kërkimore dhe metodologjinë e analizës së të dhënave cilësore dhe sasiore. Studentët do të organizohen në grupe në mënyrë që të shfrytëzojnë sinergjinë e punën në grup gjatë mbledhjes dhe analizës së të dhënave për kërkimin e vet shkencor, hartimit të raportit e studimit dhe prezantimit të tij para kolegëve në klasë.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të aftësojë studentët për punë në fushën e hulumtimit—mjeshteri thelbësore për hartimin e punimit të diplomës për arritjen e gradës akademike master i shkencës së ekonomisë. Në veçanti, lënda ka për qëllim që të ndihmojë studentët të aftësohen për mendim kritik, shkrim të mirë akademik.. Metodologjia e hulumtimit është lëndë praktike dhe zbaton mësim në veprim. Në fund të shumicës së seminareve do të organizohen diskutime në të cilat secil student do të duhej të përpiqet të gjejë përgjigje për çështjen që do të

	<p>diskutohet. Në këtë mënyrë, studentët shfrytëzojnë burimet e dijes që Fakulteti ka vënë në veprim për të ndihmuar mësimin dhe studimin. Shkalla e shfrytëzimit të këtij burimi do të varët edhe nga vullneti i secilit student të bëhet faktor nxitës i procesit mësimor dhe studimit në klasë. Përvoja e brezave të mëparshëm ka treguar se studenti që ka marr pjesë aktive në seminare ka arritur rezultate të mira në këtë lëndë.</p> <p>Pjesëmarrja në ligjërata është obligim i secilit student a studente, por ligjëruesi nuk do të vlerësojë pjesëmarrjen por mësimin. Është e palejueshme që studentët të hynë apo të dalin nga klasa apo të dikujt gjatë kohës së mësimin. Studenti mund të pyes apo të komentoj gjërat që kanë të bëjnë në lidhje me mësimin vetëm pasi të ketë ngritur dorën dhe të ketë marrë leje nga mësimdhënësi, por nuk është e lejuar me i pëshpëritë dikujt.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Studentët që kryejnë me sukses këtë lëndë mësimore do të aftësohen të kryejnë këto punë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikojnë qartë çështjen kërkimore 2. Shfrytëzojnë në mënyrë efektive literaturën shkencore 3. Operacionalizojnë konceptet kryesore në kërkimin shkencor për të mundësuar matjet empirike 4. Formojnë kornizën konceptuale ku pasqyrohen raportet midis ndryshoreve të pavarura dhe atyre të varura 5. Formulojnë qartë hipotezat në të cilat do të mbështetet kërkimi shkencor 6. Hartojnë planin kërkimor të studimit të masterit, duke përcaktuar njësinë, popullatën, listën referuese dhe mostrën e studimit 7. Analizojnë të dhënat dhe të testojnë hipotezat kryesore të studimit 8. Diskutojnë gjetjet kryesore shkencore që të dalin nga kërkimi shkencor në raport me propozicionet teorike në të cilat mbështetet studimi 9. Identifikojnë kontributin substancial, teorik dhe praktik të kërkimit të tyre (të arsyetojnë dobinë që do të ketë entiteti profesional, shkencor dhe institucional nga përdorimi i gjetjeve shkencore).
<p>Metoda e vlersimit</p>	<p>Në përpudhje me statusin e UP “.H.P”</p>
<p>Literatura</p>	
<p>Literatura bazë:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zikmund, W. G., <i>Business research methods</i>, Thompson/South-Western 2. Vujovic, M., <i>Hyrje ne metodoat hulumtuese</i>, Victory 3. <i>Wikipedia—Free encyclopaedia</i> (qasje e lirë në uebsajtin, http://www.wikipedia.org në disa gjuhë). 4. Lewis, J., <i>Studimi akademik</i> (përkthim), , KEC-CDE, Prishtinë-Tiranë 5. Neuman, W. L., <i>Social research methods: Qualitative and quantitative approaches</i>, Pearson Education, Inc., Boston, MA. 6. Eco, U., <i>Si bëhet një punim diplome</i> (përkthim), Përpjekja, Tiranë. 7. Shamiq, M., <i>Si shkruhet vepra shkencore</i> (përkthim), Logos, Shkup. 8. Ligjëratat e përgatitura nga N. Rexha

Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Cooper, D. R & P. S. Schindler, <i>Business research methods</i>, McGraw-Hill, Boston, Mass. 2. Musai, B., <i>Si të shkruajmë ese</i>, Qendra për Arsim Demokratik 3. Masden, D., <i>Successful dissertations and theses</i>, Jossay-Bass, San Francisco 4. Rexha, N. & T. Miyamoto (2001), "Supplier network knowledge management for enhanced manufacturing efficiency," <i>Practix</i>, Vo 5,
--------------------------------	--

¹ Ky klasifikim është marrë nga Programi i Vlerësimit Akademik të Akademisë së Studimeve të Avancuara Universitare (ASAU) në Prishtinë.

	<p>(September) 10 – 14. (Ju shpërndahet studentëve në format elektronik).</p> <p>5. Rexha, N. (2001), "The role of the interactive marketing plan for system-based decision making," <i>the Proceedings of the Academy of Marketing Science World Marketing Congress 2001</i>, Cardiff, Wales, UK 28 June – 1 July 2001. (Ju shpërndahet studentëve në format elektronik).</p> <p>6. Rexha, N. (2005), "The impact of internet banking service quality on business customer commitment," the Proceedings of Australia and New Zealand Academy Conference, <i>Perth 3-6 December 2005</i>. (Ju shpërndahet studentëve në format elektronik).</p> <p>7. Rexha, N. (2009) "Ndikimi i humbjes së besimit në tregjet financiare si nevojë për metoda të reja studimi në fushën e sjelljes së investuesve," <i>ANASH 6</i>, 25-28. (Ju shpërndahet studentëve në format elektronik).</p>
--	--

Plani i mësimimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Roli i kërkimit akademik në fushën e biznesit
Java e dytë:	Strategjitë e të lexuarit dhe të menduarit kritik
Java e tretë:	Rregullat themelore të shkrimit të mirë akademik
Java e katërt:	Sistemet e informacionit për menaxhimin e diturisë
Java e pestë:	Kolokuiumi I dhe Ndërtimi i teorisë në kërkimin shkencor
Java e gjashtë:	Strategjia, procesi dhe çështjet etike në kërkimet e biznesit
Java e shtatë:	Dizajni (plani) i punës kërkimore
Java e tetë:	Analiza e të dhënave cilësore (punëtori)
Java e nëntë:	Analiza e të dhënave sasiore
Java e dhjetë:	Kolokuiumi II dhe Hartimi dhe prezantimi i raportit kërkimor (punëtori)